



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:058781
Datë: 09.09.2022
Numri i dokumentit: 03406803

C.nr.343/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Mirjeta Shala, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëseve A. V. Q., B. J. P., B. B. H. dhe I. R. që të gjitha nga Gjakova, të cilat sipas autorizimit i përfaqëson i autorizuari Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson i autorizuari Dardan Bakija, për kompensimin e shpenzimeve për ushqim dhe të udhëtimit, vlera e kontestit 2,040.30€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë publik, në prani të autorizuarit të paditësve dhe në prani të përfaqësuesit të paditurës, me datën 18 gusht 2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëseve A. V. Q., B. J. P., B. B. H. dhe I. R. nga Gjakova, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditëseve të lartë cekura, të i'a paguaj:

- Paditëses A. V. Q. në emër të kompensimit të shpenzimeve për udhëtim për ditët e pranisë në punë për periudhën kohore 25.03.2018 e deri me datë 02.11.2020, respektivisht për 394 ditë të pranisë në punë, shumën prej 551.60 euro.
- Paditëses B. J. P. në emër të kompensimit të shpenzimeve për udhëtim për ditët e pranisë në punë për periudhën kohore 18.09.2018 e deri me datë 01.03.2021, respektivisht për 408 ditë të pranisë në punë, shumën prej 571.20 euro
- Paditëses B. B. H. në emër të kompensimit të shpenzimeve për udhëtim për ditët e pranisë në punë për periudhën kohore 25.03.2018 e deri me datë 01.03.2021, respektivisht për 461 ditë të pranisë në punë, shumën prej 645.50 euro
- Paditëses I. K. në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim për ditët e pranisë në punë për periudhën kohore 18.01.2021 e deri me datë 01.08.2021, respektivisht për 80 ditë të pranisë në punë, shumën prej 160,00 euro si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit për ditët e pranisë në punë për kohore 18.01.2021 e deri me datë 01.08.2021, respektivisht për 80 ditë të pranisë në punë shumën prej 112.00 euro, në shumën e përgjithshme për të dyja kërkesat prej 272.00 euro.

e gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, për secilën paditëse e cila rrjedh nga data 25.03.2021 (datë e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit.

II. DETYROHET e paditura që paditëseve t'ua kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme 976.00€, në afat prej 7 ditësh nga pranimit i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

A s y e t i m

Paditëset, përmes të autorizuarit të tyre, në këtë gjykatë me datë 25.03.2021 kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit. I autorizuari i paditësve, me parashtrësën e datës 19.07.2022 e ka bërë precizimin e kërkesëpadiës. I njëjti në padinë e precizuar, në fjalën e dhënë në seancën e shqyrtimit kryesorë dhe në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se paditëset janë punëtore të arsimit në SHFMU "Shaban Golaj" në fshatin Lipovec, komuna e Gjakovë, ndërsa të njëjtat vendbanimin e kanë në Gjakovë. Në këtë shkollë paditësja A. V. Q. për periudhën kohore që nga data 25.03.2018 e deri me datë 02.11.2020 ka vijuar 394 ditë të pranisë në vendin e punës, paditësja B. J. P. për periudhën kohore 18.09.2018 e deri me datë 01.03.2021 ka realizuar gjithësej 408 ditë të pranisë në punë, paditësja e tretë B. B. H. ka realizuar 461 ditë të pranisë në punë dhe atë për periudhën kohore nga data 25.03.2018 e deri më datë 01.03.2021, ndërsa paditësja e fundit I. R. për periudhën kohore nga data 18.01.2021 e deri më datë 01.08.2021 ka realizuar 80 ditë të pranisë Bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 dhe asaj të datës 21.01.2021, e paditura ka pasur për obligim të paditësve të i'au paguaj shpenzimet e ushqimit dhe udhëtimit. Nisur nga fakti se e paditura nuk ka përmbushur këtë obligim, paditëset kanë kërkuar këtë përmes rrugës gjyqësorë. Mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që padia dhe kërkesëpadia e precizuar e paditëseve të aprovohet si e bazuar, ashtu që të detyrohet e paditura që paditëses I. K. në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për periudhën kohore dhe për ditët e pranisë në punë, të cekura si më lartë t'ia paguaj çdo ditë x 2 euro në ditë, ndërsa në emër të shpenzimeve të udhëtimit paditëseve të lartë cekura të ia paguaj 70% të çmimit të biletës së trafikut urban, ku në bazë të vërtetimit të lëshuar nga Shoqata transportuese vërtetohet se bileta e trafikut urban në destinacion Gjakovë - Lipovec, kushton 1.00 €, e që bie për vajtje ardhje 2,00 €, ashtu që në emër të shpenzimeve të udhëtimit secilës për ditët e pranisë në punë, të i'a paguaj shumat e cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, dhe atë me kamatën ligjore prej 8% duke filluar nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe të njëjtat i ka specifikuar dhe atë: atë për taksë gjyqësore 40,00€, për përpilimin e padisë shumëën prej 260,00 € dhe për pjesëmarrjen në dy seanca gjyqësore nga 338,00€, respektivisht 676.00€, e në shumëën e përgjithshme prej 976.00 €.

E paditura përmes të autorizuarit të saj, me parashtrësën e datës 28.06.2022 i ka dorëzuar gjykatës dëshmi lidhur me ditët e prezencës në punë të paditëseve A. V. Q. përkatësisht vërtetimin me numër 347/2022 të lëshuar nga institucioni arsimor "Shaban Gola" në Lipovec për periudhën

kohore 25.03.2018 e deri më datë 02.11.2020, si dhe vërtetimin me numër 348/2022 të lëshuar nga po i njëjti institucion arsimor për paditësen B. B. H.për periudhën kohore nga data 25.03.2018 e deri me datë 01.03.2021 për te cilën periudhë konisderon se nuk është e parashkruar. I autorizuari i të paditurës tutje i ka kërkuar gjykatë që ta refuzoi kërkesë padinë e paditësve.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor-publik ku dhe administroi këto prova: Kontratë pune për paditësen A. V. Q., e lëshuar nga Komuna e Gjakovë – Drejtoria e Arsimit, në versionin e fotokopjuar me nr. leg. Nr. 480/2021 i dt. 19.02.2021, Certifikata e vendbanimit për paditësen A. V. Q. me nr. B10307138 e lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Gjakovë e dt. 19.02.2021, Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU ” Shaban Golaj ” fshatin Lipovec, Komuna Gjakovë, me nr. të protokollit 211 i datës 01.03.2021, Kontratat e punës për paditësen B. J. P. të lëshuara nga Komuna e Gjakovë – Drejtoria e Arsimit, në versionin e fotokopjuar me nr. leg. Nr. 455/21 i dt. 18.02.2021, Leg. Nr. 454/21 dt. 18/02.2021, Leg nr. 456/21 dt. 18.02.2021, Certifikata e vendbanimit me nr. B10305375 e lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Gjakovë, e datës 12.02.2021, Kontrata e punës për paditësen B. B. H.e lëshuar nga Komuna e Gjakovës– Drejtoria e Arsimit, në versionin e fotokopjuar me nr. leg. Nr. 519/21 i dt. 22.02.2021, Certifikata e vendbanimit për paditësen B. B. H.me nr. B10304895 e lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Prizren, e datës 11.02.2021, Kontrata e punës për paditësen I. R. e lëshuar nga Komuna e Gjakovës– Drejtoria e Arsimit, në versionin e fotokopjuar me numër leg. Nr. LRP1413/21 i datës 16.02.2021, Certifikata e vendbanimit e paditësës I. R. me numër B10304809 e lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Gjakovë, me datë 10.02.2021, Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Shaban Golaj” fshati Lipovec për paditësen A. V. Q., me numër të protokollit 347/22 dt. 28.06.2022, Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Shaban Golaj” fshatin Lipovec për paditësen B. B. H., me numër të protokollit 348/22 dt. 28.06.2022, Vërtetimi i lëshuar nga Shoqata e Transportit të udhëtarëve, Vërtetimi lëshuar nga SHFM “Shaban Golaj” me numër protokollit 259 e datës 15.07.2022.

Nga Kontrata e punës e lëshuar nga Komuna e Gjakovë – Drejtoria e Arsimit, në versionin e fotokopjuar, të vërtetuara nr. leg. Nr. 480/2021 i d19.02.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja A. V. Q. është në marrëdhënie pune te paditura Komuna e Gjakovës–Drejtoria e Arsimit, respektivisht në Institucionin Arsimor: Shkolla “Shaban Golaj” në fshatin Lipovec, Komuna e Gjakovës. Ndërsa Certifikata e vendbanimit me numër B10307138 e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë, gjykatës i ka vërtetuar rrethanën se e njëjta e ka vendbanimin në Gjakovë,” Rr. . . . ” Komuna e Gjakovës. Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Shaban Golaj” në fshatin.Lipovec për paditësen A. V. Q., me nr. të protokollit 347/22 i datës 28.06.2022 gjykates i ka vërtetuar faktin se për periudhën kohore nga data 25.03.2018 e deri me datën 02.11.2020, paditësja ka realizuar 394 ditë të pranisë në vendin e punës.

Nga Kontratat e punës te lëshuara nga Komuna e Gjakovë – Drejtoria e Arsimit, në versionin e fotokopjuar, me nr. leg. Nr. 455/21 i dt. 18.02.2021, Leg. Nr. 454/21 dt. 18/02.2021, Leg nr. 456/21 dt. 18.02.2021 gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja B. J. P. është në marrëdhënie pune te e paditura Komuna e Gjakovës–Drejtoria e Arsimit, respektivisht në Institucionin Arsimor: Shkolla “Shaban Golaj” në fshatin Lipovec, Komuna e Gjakovës, e në anën tjetër certifikata e vendbanimit me nr. B10305375 e lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Gjakovë, e dt. 12.02.2021,

gjykatës i ka vërtetuar faktin se paditësja e ka vendbanimin në Gjakovë, në rrugën “. . .” në Gjakovë. Nga Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU ” Shaban Golaj ” fshatin Lipovec, Komuna Gjakovë, me nr. të protokollit 211 i datës 01.03.2021 gjykata vërtetoi faktin se për periudhën kohore nga data 18.09.2018 e deri më datën 01.03.2021 paditësja B. J. P. ka realizuar 408 ditë të pranisë në punë referuar këtu shpenzimeve të udhëtimit.

Nga Kontrata e punës e lëshuar nga Komuna e Gjakovë – Drejtoria e Arsimit, në versionin e fotokopjuar, të vërtetuara me nr. leg. Nr. 519/21 i dt. 22.02.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja Blerina Buza Halilaj është në marrëdhënie pune te e paditura Komuna e Gjakovës– Drejtoria e Arsimit, respektivisht në Institucionin Arsimor: Shkolla “Shaban Golaj” në fshatin Lipovec Komuna e Gjakovës. Nga Certifikata e vendbanimit me numër B10304895 e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Prizren, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja Blerina Buza Halilaj e ka vendbanimin në Gjakovë, në rrugën “. . .”, ndërsa nga vërtetimi i lëshuar nga SHFM “Shaban Golaj” fsh. Lipovec për paditësen B. B. H., me nr. të protokollit 348/22 dt. 28.06.2022 gjykata ka vërtetuar faktin se për periudhën kohore nga data 25.03.2018 e deri më datë 01.03.2021 paditësja ka realizuar 461 ditë të pranisë në vendin e punës.

Nga Kontrata e punës e lëshuar nga Komuna e Gjakovë – Drejtoria e Arsimit, në versionin e fotokopjuar, të vërtetuara me Nr. LRP1413/21 i datës 16.02.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja I. R. është në marrëdhënie pune te e paditura Komuna e Gjakovës–Drejtoria e Arsimit, respektivisht në Institucionin Arsimor: Shkolla “ Shaban Golaj ” në fshatin Lipovec Komuna e Gjakovës. Nga Certifikata e vendbanimit me numër B10304809 e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja I. R. e ka vendbanimin në Gjakovë, në rrugën “ Nëna Terezë me numër 26”. Nga vërtetimi lëshuar nga SHFM “Shaban Golaj” me nr. protokollit 259 e dt. 15.07.2021 për paditësen I. K., gjykata vërtetoi faktin se për periudhën kohore nga data 18.01.2021 e deri me datë 01.08.2021 paditësja ka realizuar 80 ditë të pranisë në vendin e punës.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve në Gjakovë, për relacionin Gjakovë–Lipovec, gjykata ka vërtetuar faktin se çmimi i biletës së trafikut në relacionin Gjakovë Demjan në një drejtim është 1.00 euro.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore,(më tutje LPK-së), arriti në përfundim se në këtë çështje juridikë kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e dy Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe ajo e viti 22.01.2021, sepse kërkesa për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punës për vitin 2020 mbulohet nga kontrata kolektive e datës 18.04.2017 e ndërsa pjesa tjetër për vitin 2021, mbulohet me kontratën kolektive të datës 22.01.2021.

Në nenin 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë me nr. 01B-2056 e datës 18.04.2017 dhe të asaj të datës 22.01.2021 në mënyrë identike është paraparë që është paraparë

se: *“Mësimdhënësit që udhëtojnë në vendbanimet e Komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*. Gjykata nga administrimi i provave të cilave prova dhe ja fali besimin e plot, gjeti se paditëset janë në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht në Shkollën Fillore” Shaban Golaj” fshati Lipovec, komuna e Gjakovës, u vërtetua se paditëset vendbanimin e kanë në Gjakovë, fakt i provuar sipas Certifikatave të vendbanimit për secilën paditëse, ndërsa të njëjta punojnë në SHFMU ” Shaban Golaj ” në fshatin Lipovec, komuna e Gjakovës. Duke qenë se vend punimi i paditëseve ka qenë jashtë vendbanimit të tyre, rezultoi se të njëjtat kanë udhëtuar brenda vendbanimit të Komunës përkatëse ku punojnë. Lartësinë e kërkesë padisë lidhur me këtë kriter të kompensimit, gjykata e vërtetoi në bazë të vërtetimit të lëshuar nga Shoqata e Transportit në Gjakovë, ku lartësia e çmimit të biletës kthye për relacionin Gjakovë - Lipovec është 2.00 euro në ditë, kthye. Andaj, për faktin që e paditura, paditëseve nuk i’au ka paguar shpenzimet e udhëtimit të parapara me dispozita ligjor të lartëcekura, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëseve edhe për këtë kriter të kompensimit është e themeltë, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit bëri përlllogaritjen në atë mënyrë që, ditët e kaluara në punë të paditëseve i ka shumëzuar me 70% të çmimit të biletës së trafikut urban në relacionin ku të njëjtat kanë udhëtuar duke u’ a njohur secilës prej tyre shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kërkesën tjetër të paditëses se trete I. R. lidhur me kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, gjykata iu referua nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit me nr. 01B-2056 e datës 18.04.2017 dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës 01/B e cila ka hyrë në fuqi me datën 22.01.2021, në të cilin në mënyrë identike parashihet se *“Të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore”*. Duke u nisur nga fakti se e paditura, paditëses nuk i’ a ka paguar shpenzimet e ushqimit të parapara me dispozita ligjor të lartë cekura, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit bëri përlllogaritjen në atë mënyrë që, ditët e kaluara në punë të paditëses, i ka shumëzuar me 2, duke i’au njohur shumën si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, me rastin e vendosjes murr parasysh edhe nenin 90 paragrafi 5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, me të cilin parashihet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Sipas neneve të lartë cituara të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë detyrimi i punëdhënësit në rastin konkret i të paditurës për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit e nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e cila prodhon efekt juridik ndaj punëdhënëses të cilët kanë të punësuar punëtorët që të drejtat e tyre burojnë nga ajo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditëses dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ato kontrata.

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien*

e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditoreve, përkatësisht këtu paditëseve në rastin konkret, të ia paguajë vlerën e kërkesëpajdisë si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatëvonesën gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç ‘rast paditëseve i’u pranua shume e përgjithshme e shpenzimeve në vlerë prej 976.00€. Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 40,00 € (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 260.00 €, si dhe përfaqësimin e të autorizuarit të paditësve në dy seancë, shuma në vlerë prej 676.00 € të parapara sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës).

Prandaj, gjykata, bazuar ne arsyet e cekura me larte, bazuar ne nenin 143 të LPK-së, vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr 343/21 datë 18 gusht 2022.

Gj y q t a r j a,
Mirjeta Shala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita vijuese pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.